



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 857/8 Prot

Tiranë, më 05/10/2020

VENDIM

Nr. 41, datë 05.10.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETEVE PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularët e Ankesave nr. 857 Prot., datë 13.07.2020 dhe nr. 857/2 Prot., datë 10.08.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoriteteve Publike “Fondi Shqiptar i Zhvillimit” (në vijim “FSHZH”) dhe “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (në vijim “MFE”).

FSHZH, me emailin e datës 24.07.2020 ka deleguar pranë MFE-së, kërkesën për informacion të ankuesit duke kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. *Kopje e gjithë dokumentacionit të vlerësimit të kryer nga grupi ndërinstitucional i ngritur në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 234, datë 17.4.2019 “Për Programin e Integruar të Zhvillimit “Poli i Drejtësisë”, për gjendjen juridike të pronësisë së godinës të ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë; gjendjen ligjore të pronësisë së truallit ku është ndërtuar kjo godinë dhe lidhur me përcaktimin e vlerës së kësaj pasurie të paluajtshme.*
2. *Të dhëna dhe dokumentacion mbi vlerën fillestare të investimit të godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ku është bazuar grupi ndërinstitucional i punës për vlerësimin e këtij sendi të paluajtshëm.*

3. *Informacion të shoqëruar me dokumentacion për vlerën përfundimtare të godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë e përcaktuar nga grupi ndërinstytucional i punës që inicion procedurën e negociimit me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për blerjen e godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë.*
4. *Kopje e gjithë procedurës së negociimit me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për blerjen e godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë.*
5. *Kopje e plotë e projekt-kontratës për blerjen e godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë, të përgatitur nga grupi ndërinstytucional i punës i ngritur në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.234, datë 17.4.2019 "Për Programin e Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë", së bashku me kopje të dokumentacionit teknik ku është bazuar projekt kontrata.*

MFE me emailin datë 05.08.2020 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *"Në zbatim të VKM-së nr. 234, datë 17.04.2019 "Për Programin e Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë" dhe të VKM-së nr. 356, datë 26.2.2020 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Drejtësisë tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për Ndërmarrjen Industriale Nr. 1, Tiranë, të pasurisë nr. 1/645, Zona kadastrale nr. 8210, Tiranë, dhe miratimin e projekt-kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të mësipërme, për qëllim të zbatimit të programit të integruar të zhvillimit "Poli i Drejtësisë", e gjithë procedura ligjore është iniciuar nga Drejtoria e Çështjeve Rregullatore dhe struktura e cila është ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi është Ndërmarrja Industriale Nr.1 Tiranë.*

Pas përgjigjes së dhënë nga MFE, ankuesi me emailin e datës 07.08.2020 i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit" dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, Zyra e Komisionerit, kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë MFE-së, duke kërkuar vlerësimin e dhënies së informacionit.

Në vijim, MFE me shkresën nr. 16043 Prot., datë 31.08.2020, ka kthyer përgjigje duke vënë në dispozicion një pjesë të dokumentacionit të kërkuar. Gjithashtu, me emailin e datës 10.09.2020 është shprehur konkretisht si më poshtë vijon:

Në lidhje me pikën 1, MFE nuk e disponon informacionin e kërkuar, pasi procedura e prokurimit të ekspertit, bazuar në pikën 5.4, të Vendimit nr. 234, datë 17.4.2019 "Për Programin e Integruar të Zhvillimit 'Poli i Drejtësisë'", të Këshillit të Ministrave, është realizuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Rrjedhimisht edhe raporti i vlerësimit, pra shërbimi i kryer, disponohet nga institucioni në fjalë.

Në lidhje me pikën 2, MFE nuk e disponon informacionin e kërkuar, pasi nuk është palë në kontratën e shitblerjes. Këtë informacion mund ta kërkontë pranë Ndërmarrjes Industriale Nr.1 Tiranë.

Në lidhje me pikën 3, informacioni që disponojmë është përcjellë me shkresën nr.16043 prot, datë 31.08.2020. Protokollimi dhe data e vendimeve të Këshillit të Ministrave realizohet nga Qendra e Publikimeve Zyrtare (QPZ), e cila pasi i protokollon, i publikon ato në faqen e saj zyrtare.

Në lidhje me pikën 4, informacioni që disponojmë është përcjellë me shkresën nr.16043 prot, datë 31.08.2020. Në bazë të ligjit për të drejtën e Informimit, ky informacion është zyrtar dhe vula gjendet në shkresën përcjellëse në fjalë. Gjithashtu, sqarojmë se aktet në Këshillin e Ministrave propozohen nëpërmjet sistemit e-akte dhe kopja e dhënë është gjeneruar nga sistemi.

Në lidhje me pikën 5, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk e disponon informacionin e kërkuar, për arsye se procedura e negociimit është realizuar nga Grupi Ndërinstitucional.

Vlerësojmë për të sqaruar se, Ministria e Financave dhe Ekonomisë bazuar në pikën 5.3 (Citat: Në përfundim të procesit të negociimit, grupi ndërinstitucional i punës përgatit projektkontratën e blerjes, e cila i përcillet për miratim Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë), përcjell projektvendimin bashkë me draft kontratën e negociuar nga Grupi Ndërinstitucional, pranë Këshillit të Ministrave.

Për sa më sipër, MFE-së i është dërguar projektvendimi me relacionin shpjegues dhe draftkontrata, nga grupi ndërinstitucional i punës. Më tej MFE ka vijuar procedurat e konsultimit të jashtëm, duke e dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokaturës së Shtetit. Mbas marrjes së mendimeve, projektakti është dërguar në Këshillin e Ministrave.

Në lidhje me këtë procedurë MFE, me shkresën nr.16043 prot, datë 31.08.2020, ka dërguar gjithë informacionin që disponon."

Pas përgjigjes së dhënë nga MFE, ankuesi me emailin e regjistruar nr. 857/5 Prot., datë 11.09.2020 ka vijuar ankimin duke kërkuar plotësimin e dokumentacionit, që nuk i është vënë në dispozicion.

Në vijim, MFE me emailin datë 16.09.2020 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *"për pikën 2 të kërkesës informacioni disponohet nga FSHZH dhe në lidhje me kontratën për blerjen e godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë me shkresën nr.16043/1 Prot., datë 19.09.2020 ka deleguar për trajtim kërkesën për informacion tek Ndërmarrja Industriale Nr.1."*

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të Ligjit nr. 119/2014, në të cilin parashikohet se: *"...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", bazuar dhe në nenet 41,64,77 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore duke ftuar autoritetet publike MFE dhe FSHZH.*

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 23.09.2020, me prezencën e ankuesit z. nga njëra anë dhe përfaqësuesve të MFE dhe FSHZH nga ana tjetër.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi dhe përfaqësuesit e MFE rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Ndërsa, përfaqësuesit e FSHZH-së sqaruan se *"....bazuar në VKM nr. 234 datë 17.04.2019 "Për programin e integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë" është parashikuar zhvillimi në dy faza i këtij programi. Për zbatimin e fazës së parë është krijuar grupi ndërinstytucional i punës dhe faza e dytë do vijojë me veprimet e tjera, sikurse përcakton VKM në fjalë. Ky grup ndërinstytucional ka kryer punë të pavarur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe dokumentacioni i hartuar nga grupi është menaxhuar nga strukturat përkatëse, në funksion të përgatitjes së draftkontratës së blerjes. Fondi Shqiptar i Zhvillimit nuk ka qenë palë në kontratën e blerjes, e cila është lehtësisht e aksesueshme në faqen zyrtare të QPZ. Për këtë arsye në kuadër të parashikimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, FSHZH nuk mund të përpunonte/shpërndante kontratën e blerjes, përse kohë nuk ishte palë e kësaj kontrate dhe nuk kishte një pëlqim paraprak nga palët kontraktore". Gjithashtu, Fondi Shqiptar i Zhvillimit funksionon në përputhje me ligjin nr. 10 130, datë 11.05.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit" i ndryshuar. Bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji, FSHZH-është person juridik dhe gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, gëzon pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike. Përse më sipër rezulton se FSHZH nuk është autoritet publik sipas përkufizimit të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit"*.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoi përfaqësuesve të FSHZH-së dhe MFE-së për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur, ndërsa ankuesit i kërkoi të identifikojë pikat e kërkesës për të cilat nuk ka marrë përgjigje.

MFE, me emailin datë 29.09.2020 ka kthyer përgjigje me arsyetimin se: *"Në lidhje me kërkesën për informacion: - gjendjen juridike të pronësisë së godinës të ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë; gjendjen ligjore të pronësisë në truallit ku është ndërtuar kjo godinë dhe lidhur me përcaktimin e vlerës së*

kësaj pasurie të paluajtshme; - procedura e negocimit mes grupit ndërinstytucional dhe Dhomës së Avokatisë, sqaron se Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk e disponon informacionin e kërkuar. Bazuar në pikën 5.3 dhe 5.4 të Vendimit nr. 234, datë 17.4.2019 "Për Programin e Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë"", të Këshillit të Ministrave, si dhe pikave 5, 8 dhe 9, të Urdhërit nr. 9, datë 14.05.2019 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstytucional të punës për zbatimin e fazës së parë të programit të integruar të zhvillimit "Poli i Drejtësisë", Fondi Shqiptar i Zhvillimit është organi që ka detyrimin të administrojë praktikën dokumentare të grupit ndërinstytucional të punës. Vlerësojmë për të sqaruar se, Ministria e Financave dhe Ekonomisë bazuar në pikën 5.3 (Citat: Në përfundim të procesit të negocimit, grupi ndërinstytucional i punës përgatit projektkontratën e blerjes, e cila i përcillet për miratim Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë), përciell projekt vendimin bashkë me draft kontratën e negociuar nga Grupi ndërinstytucional, pranë Këshillit të Ministrave. Bashkëlidhur vendos projektvendimin dhe draftkontratën e nënshkruar nga organet kompetente sipas formatit të kërkuar në takimin pranë Komisionerit si dhe kthim përgjigje nga Ministria e Drejtësisë (me firma dixhitale)".

Ankuesi, pas përgjigjes së dhënë nga ana e autoriteteve publike përkatëse, me emailin e datës 01.10.2020 ka konsideruar të plotë përgjigjen për pikën 3 të kërkesës si dhe pjesërisht për pikën 5 të kërkesës "Kopje e e plotë e projekt kontratës për blerjen e godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë, të përgatitur nga grupi ndërinstytucional i punës i ngritur në zbatim të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr.234, datë datë 17.4.2019 "Për Programin e Integruar të Zhvillimit "Poli i Drejtësisë".

Në lidhje me pikat 1, 2, 4 dhe për pjesën tjetër të pikës 5. kopje të dokumentacionit teknik ku është bazuar projekt-kontrata, nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar.

Pas shqyrtimit të legjislacionit dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se MFE ka përmbushur detyrimin për dhënie informacioni në lidhje me pikën 3 të kërkesës dhe pjesërisht për pikën 5. Rrjedhimisht, MFE ka detyrimin të përmbushë detyrimin duke vënë në dispozicion të kërkuarit dokumentacionin e plotë për pikën 5 të kërkesës për informacion.

Përsa i përket Autoritetit Publik/FSHZH, bazuar në nenin 77 të Kodit të Procedurave Administrative, mbas kryerjes së një hetimi të plotë dhe shqyrtimit të kujdesshëm të fakteve dhe rrethanave të administruara gjatë zhvillimit të procedurës administrative, mbështetur gjithashtu dhe në qëndrimin dhe argumentat e dhëna nga palët në seancën dëgjimore të datë 23.09.2020, rezulton se FSHZH është Autoriteti Publik i ngarkuar për administrimin e praktikës dokumentare të kërkuar për pikat e tjera të kërkesës.

Konkretisht, bazuar në Urdhërin nr. 9, datë 14.05.2019 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërinstytucional të punës për zbatimin e fazës së parë të programit të integruar të zhvillimit "Poli i Drejtësisë" të Kryeministrit, pikës 5 të tij "Komunikimet zyrtare të

grupit ndërinstitutional të punës, të adresuara institucioneve të tjera, iniciohen zyrtarisht dhe nënshkrohen nga kryetari i grupit ndërinstitutional të punës dhe marrin vulën zyrtare të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”; të pikës 8 “Kontraktimi i ekspertit/ëve teknikë apo çdo subjekti tjetër të nevojshëm kryhet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, sipas nevojave të parashikuara dhe të adresuara nga grupi ndërinstitutional i punës në mbledhjen e parë” dhe pikës 9 “Grupi ndërinstitutional i punës asistohet nga një staf i dedikuar i Fondit Shqiptar të Zhvillimit në gjithë punën e tij. Stafit teknik i Fondit Shqiptar të Zhvillimit merr masa për përgatitjen e minutave të takimit, vendimeve dhe çdo korrespondencë të grupit ndërinstitutional të punës dhe administron dokumentacionin në një dosje të posaçme”, si dhe në bazë pikës 5.3 “Në përfundim të procesit të negocimit, grupi ndërinstitutional i punës përgatit projektkontratën e blerjes, e cila i përcillet për miratim Këshillit të Ministrave, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” dhe pikës 5.4 “Grupi ndërinstitutional i punës, gjatë punës së tij, mund të asistohet nga ekspertë teknikë që do të jenë të ngarkuar të bëjnë vlerësimin e godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Kontraktimi i ekspertëve teknikë kryhet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit” si dhe Vendimin nr. 234, datë datë 17.4.2019 “Për Programin e Integruar të Zhvillimit ‘Poli i Drejtësisë’”, FSHZH ka detyrimin të administrojë praktikën dokumentare të grupit ndërinstitutional të punës dhe për rrjedhojë të disponojë dokumentacionin e kërkuar.

Për sa i përket argumentit të parashtruar nga FSHZH, sipas së cilit: “...në përputhje me pikën 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 130, datë 11.05.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit” i ndryshuar, FSHZH nuk është autoritet publik, sipas përkufizimit të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Komisioneri vlerëson se, ky argument nuk qëndron.

Ligji nr. 10130, datë 11.05.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, i ndryshuar, neni 2 i tij përcakton se: “Fusha e veprimtarisë së FSHZH-së është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit”, ndërkohë në nenin 6 përcaktohen Objektivat e FSHZH-së, sipas të cilit: “Në përmbushjen e funksioneve dhe të kompetencave të parashikuara në këtë ligj, FSHZH-ja udhëhiqet nga këta objektiva kryesorë: a) përmirësimi i infrastrukturës social-ekonomike vendore; b) përmirësimi i shërbimeve publike vendore; c) forcimi institucional i njësive të qeverisjes vendore; ç) nxitja e qeverisjes së mirë në nivel vendor”.

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” në nenin 1 të tij, objekti dhe qëllimi, parashikon se: 1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Ndërkohë, në pikën 1 të nenit 2 të këtij ligji përcaktohet qartë se: “Autoritet publik”:a) është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat

administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipasparashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike".

Në kuptim të parashikimeve të mësipërme, FSHZH edhe pse gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse, pavarësi drejtuese, administrative, financiare dhe teknike, është person juridik, i cili ushtron funksione publike dhe nuk përjashtohet si subjekt i ligjit nr.119/2014. Për rrjedhojë, detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, për më tepër që informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, lidhet me mënyrën e menaxhimit të fondeve publike, mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të ligjit nr. 19/2014 "Për të drejtën e Informimit".

Lidhur me legjitimitimin e FSHZH si subjekt i ligjit nr.119/2014, referuar një vendimmarrje të mëparshme, Komisioneri vlerëson se analiza e mësipërme, vjen në përputhje të plotë me përcaktimet e pikës "ç" të nenit 11, të Kodit të Procedurave Administrative.

Po ashtu, në kundërshtim me sa pretendohet, statusi i FSHZH-së, si subjekt i ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" është pranuar dhe nga vet Autoriteti Publik nëpërmjet zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në nenet 6, 7, 8 dhe 10 të këtij ligji. reflektuar në faqen e tyre zyrtare në internet <https://www.albaniandf.org/programi-i-transparences/>.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik". Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

Autoriteti Publik, gjatë vënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon

qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 të ligjit për të drejtën e informimit, parashikohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për atë që nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë. Bazuar në sa më sipër, mosveprimi në përputhje me parashikimet e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe detyrimin sipas këtij vendimi, passjell vendosjen e penaliteteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 18, ndaj personave përgjegjës.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. _____ ndaj Autoriteteve Publike/Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesave nr. 857 Prot., datë 13.07.2020 dhe nr. 857/2 Prot., datë 10.08.2020 të z. _____, kundër Autoriteteve Publike “Fondi Shqiptar i Zhvillimit” dhe “Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Fondi Shqiptar i Zhvillimit për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar për pikat 1, 2 dhe 4 të kërkesës për informacion, konkretisht: (1. Kopje e gjithë dokumentacionit të vlerësimit të kryer nga grupi ndërinstytucional i ngritur në zbatim të Vendimit e Këshillit të Ministrave nr. 234, datë 17.4.2019 “Për Programin e Integruar të Zhvillimit “Poli i Drejtësisë”, për gjendjen juridike të pronësisë së godinës të ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë; gjendjen ligjore të pronësisë së truallit ku është ndërtuar kjo godinë dhe lidhur me përcaktimin e vlerës së kësaj pasurie të paluajtshme. 2. Të dhëna dhe dokumentacion mbi vlerën fillestare të investimit të godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, ku është bazuar grupi ndërinstytucional i punës për vlerësimin e këtij sendi të paluajtshëm, dhe 4. Kopje e gjithë procedurës së negociimit me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për

blerjen e godinës së ndërtuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në zonën kadastrale nr. 8210, Tiranë), brenda datës 12 . 10 .2020.

3. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas pikës 5 të kërkesës për informacion (kopje të dokumentacionit teknik ku është bazuar projekt kontrata), brenda datës 12 . 10 .2020.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 05 . 10 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

